

THIRRJE E HAPUR PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË*

Trajnim për ngritjen e kapaciteteve për organizatat e shoqërisë civile
“Dialogu ndërkulturor dhe puna rinore online”

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) Zyra Lokale në Kosovë në partneritet me Misionin e OSBE-së në Kosovë, fton organizatat e shoqërisë civile në Kosovë të marrin pjesë në trajnimin “Dialogu ndërkulturor dhe puna rinore online” me qëllim të ngritjes dhe forcimit të aftësive në përgatitjen dhe implementimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkulturor, punës rinore dixhitale, mobilitetit, dhe aktivizmit rinor në Ballkanin Perëndimor.

Trajnimi synon të përmirësojë aftësitë e organizatave për të identifikuar sfidat në komunitetin lokal dhe më gjerë, të përgatisë dhe të shkruajë projekt-propozime në fushën e dialogut ndërkulturor, punës rinore online, bashkëpunimit rajonal dhe pajtimit të të rinjve përmes programeve të shkëmbimeve rinore.

QËLLIMI I TRAJNIMIT:

Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është ngritja e nivelit të njohurive dhe aftësive të organizatave mbi dialogun ndërkulturor, duke respektuar parimet e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të të rinjve dhe implementimin online të aktiviteteve rinore duke përdorur mjete dixhitale, si dhe për të përgatitur në mënyrë të pavarur dhe me sukses projekt-propozime.

Përmes një trajnimi gjashtë-ditor, pjesëmarrësit do të:

- të njihen me konceptet e mësimit ndërkulturor, pajtimit, përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve, dhe mundësi të krijimit të partneriteteve në rajon;
- të njihen me konceptet e punës rinore dixhitale, dhe të njoftohen me platformat dhe mjetet dixhitale të implementimit të programeve rinore;
- marrin një bazë teorike për përgatitjen dhe elaborimin e një projekt-propozimi;
- kenë mundësinë për të punuar praktikisht dhe në mënyrë të pavarur në grupe të vogla në zhvillimin e elementeve të përgjithshme në aplikimet e projektit - nga identifikimi dhe justifikimi i idesë përmes përcaktimit të qëllimeve dhe krijimit të një buxheti dhe aktivitete reale;
- përvetësojnë njohuri dhe do të ngrisin kapacitetet në zbatimin e programeve ndërkulturore të shkëmbimeve rinore.

Trajnimi do të mbahet online dhe do të zgjasë 5 ditë, 2 orë në ditë, dhe do të zhvillohet në gjuhën shqipe/serbe-boshnjake /angleze.

*Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS-së, të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Pjesëmarrësit e trajnimit do të marrin një Certifikatë të Pjesëmarrjes Aktive në trajnim, në rast se përcjellin 80% të trajnimit.

DATAT E TRAJNIMIT:

Moduli I Pare: 25 Shtator dhe 28 Shtator;

Moduli I Dytë: 30 Shtator;

Moduli I Tretë: 1 dhe 2 Tetor

PLATFORMA E TRAJNIMIT: ZOOM

KOHËZGJATJA: 5 ditë, 2 orë në ditë

KRITERET PËR APLIKIM:

Trajnimi është menduar ekskluzivisht për përfaqësuesit e organizatave në Kosovë që nuk kanë ose kanë përvojë modeste në përgatitjen dhe shkrimin e projekt-propozimeve dhe zbatimin e tyre.

Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që mund të aplikojnë janë ata:

- të cilët planifikojnë të përgatisin/shkruajnë një projekt-propozim përmes organizatës së tyre;
- të cilët do të marrin pjesë në trajnim në mënyrë të plotë;
- të cilët deri më tani nuk kanë qenë implementues të projekteve rajonale;
- të cilët deri më tani nuk kanë pasur projekte të financuara nga RYCO;
- të cilët kanë aplikuar më parë në thirrjet e RYCO-s por nuk kanë fituar ndonjë grant.

REGJISTRIMI:

AFATI PËR APLIKIM

Thirrja mbetet e hapur deri më **20.09.2020**.

APLIKIMET DUHET TË DORËZOHEN

Përmes formularit në internet të vendosur në:

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdQzMpohliGXCb7h0gOebxAvTTIdR508_KXBPDZtdCrHtDdXw/viewform

Vetëm një person mund të aplikojë në emër të një organizate.

SHËNIM:

Pjesëmarrësit do të përzgjidhen në bazë të kriterëve të përcaktuara në Thirrjen për Aplikim sipas cilësisë së aplikimit të dorëzuar, duke marrë parasysh barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen dhe ekuilibrin gjeografik. Pjesëmarrja në trajnim nuk garanton ndarjen e fondeve nga RYCO ose Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Kur aplikoni, ju lutemi merrni parasysh që të gjithë pjesëmarrësit e përzgjedhur për të marrë pjesë do të informohen deri më 22.09.2020 me email.

Çdo pyetje eventuale mund të drejtohet

- në zyrën lokale të RYCO-s në Kosovë përmes email-it ramadan.sokoli@rycowb.org.

PËR ORGANIZATORËT

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) është një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i themeluar nga 6 pjesëmarrës të Ballkanit Perëndimor (WB6): Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, me qëllim promovimin e frymës së pajtimit dhe bashkëpunimi midis të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimeve rinore. Për më shumë informata vizitoni www.rycowb.org

Misioni i OSBE-së në Kosovë - organizon një varg aktivitete të ndryshme, duke filluar nga zhvillimi i institucioneve demokratike dhe pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje, deri te promovimi i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Në veçanti angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, monitorimin e gjyqësorit, reformën e qeverisjes lokale, dhe zhvillimin e institucioneve të pavarura, siç janë Institucioni i Avokatit të Popullit, Komisioni i Pavarur për Media, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Policia e Kosovës. Misioni monitoron punën e institucioneve dhe ndihmon fuqizimin e legjislacionit dhe të politikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, anti-diskriminimin, lirinë e shprehjes, barazinë gjinore dhe luftën kundër krimit të organizuar. Për më shumë informata vizitoni www.osce.org/sq/mission-in-kosovo